



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore**  
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

---

Prishtinë, 14.12.2016

### **Takim me institucionet e trashëgimisë kulturore**

Më ftesë të KKTK me datë 14.12.2016, është zhvilluar takimi konsultativ për të diskutuar formën e re të aplikimit si dhe çështje të tjera mbi procesin e shpalljes në mbrojtje të përhershme të trashëgimisë kulturore. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për trashëgimi kulturore.

Fillimisht kryetari i KKTK Shafi Gashi ju dëshiroj mirëseardhje dhe i falënderoj për përgjigje në ftesën e KKTK-së, për të diskutuar lidhur më formën e re të aplikimit dhe çështjeve të tjera, gjithashtu njoftoi të pranishmit mbi punën e KKTK në trajtimin e dosjeve të propozuara nga MKRS.

Duke pas parasysh se procesi i shpalljes në mbrojtje të përhershme zhvillohet për herë të parë në Republikën e Kosovës, KKTK ka kaluar nëpër disa sfida, për të cilat është punuar një kohë të gjatë që të tejkalohen.

Aplikacioni që është përdorur për të propozuar asete për shpallje në mbrojtje të përhershme është modifikuar për të lehtësuar procesin, pasi që është parë si dokument jo i qartë nga institucionet të cilat obligohen të përdorin.

Aplikacionin e modifikuar e prezantoi Isuf Koci, u.d. udhëheqës ekzekutiv i KKTK, duke kërkuar nga të pranishmit që deri më datë 21.12.2016, të dorëzojnë të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e tyre për formën dhe përmbajtjen e aplikacionit.

Takimi filloj në ora 10:00 dhe përfundoj në ora 12:30.



Takim me institucionet e trashëgimisë kulturore